



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 495/3 Prot.

Tiranë, më 29 . 04 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 117, Datë 29 . 04 . 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 61, datë 27.03.2024, e z. J. S, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: “Me datë 26 janar 2024, kam ardhur në dijeni të faktit që jam skualifikuar nga procesi konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë me argumentin se nuk plotësoj kriteret ligjore për të qenë pjesë në Akademinë e Sigurisë. Në e-mailin e dërguar nga burimet njerëzore pranë DPPSH-së, jam njoftuar që unë skualifikohem pasi kam probleme me “vertetimin e besueshmërisë”. Pas marrjes dijeni, kam bërë ankesë lidhur me sa më sipër, por përsëri nëpërmjet e-mailit me datë 2 shkurt 2024, më është komunikuar se, vendimi nr. 1, datë 25.01.2024, i Komisionit të Vlerësimit është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankesave dhe për këtë shkak unë skualifikohem nga procesi i konkurimit pasi nuk plotësoj kriterin e besueshmërisë për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.

*Unë personalisht nuk jam shoqëruar asnjëherë në Komisarariat apo në Drejtorinë Vendore të Policisë, nuk jam hetuar e as dënuar me asnjë vendim gjykate, fakte këto lehtësisht të verifikueshme. Në certifikatën time familjare kam vetëm nënën aktualisht, por në momentin e aplikimit kam patur edhe babain, i cili fatkeqësisht ndërroi jetë disa muaj pas aplikimit tim. Gjithashtu, familjarët e mi të lartpërmendur, nuk kanë, as nuk kanë patur probleme me drejtësinë shqiptare apo më gjerë.*

*Nga interesimi im pranë DPPSH-së, Drejtuesi i Parë z. Z. L, në mënyrë joformale më informon se vëllezërit e mi nga ana e babait, pra nga një martesë e mëparshme e babait tim të ndjerë, kanë pasur një dënim në Mbretërinë e Bashkuar. Personat e mësipërm nuk janë dhe nuk kanë qenë në certifikatën time familjare, të paktën për 10 vitet e fundit, dhe de facto dhe de jure, nuk më lidh asgjë me personat e mësipërm. E aq më pak me dënimet apo zgjedhjet e tyre në jetë. Nga Drejtuesi i Parë i Policisë mora thjesht një përgjigje pa ndonjë arsyetim logjik të arsyeshëm.*

*A duhet të jem unë i sakrifikuari në këtë rast dhe të mbaj të tillë përgjegjësi, kur unë kam plotësuar formularin e Vetëdeklarimit të nxjerrë nga vetë DPPSH-ja, në të cilin sqarohet mjaft qartë termi anëtar familje. Për më tepër citoj, se: ““Me termin anëtar familjeje” do të kuptohet bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët madhorë, bashkëjetuesi/it si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.” Ky term dhe bashkësia për të cilën unë duhet në një formë apo në një tjetër të jap llogari është e sqaruar mjaft qartë nga vetë organi që sot mban një qëndrim kontradiktor.”*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave të nevojshme.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që

<sup>1</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

krijonjë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 61, datë 27.03.2024, të bërë nga z. J. S, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 495/2, datë 02.04.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga DPPSH për ankesën e bërë dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:

- Parashtrimet e DPPSH-së, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kriteret dhe dokumentacioni që duhet plotësuar nga aplikantët në konkurimin e shpallur, pjesë e të cilit ishte dhe subjekti ankues.
- Kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesi.
- Informacion lidhur me arsyet për të cilat ankuesi nuk është kualifikuar për të vijuar studimet në Akademinë e Sigurisë.
- Kopje të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit të Pranimi, për skualifikimin e ankuesit.
- Kopje të dokumentit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e besueshmërisë së shtetasit J. S, ku cilësohen arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijim e studimeve në Akademinë e Sigurisë.
- Informacion dhe dokumentacion shoqërues me anë të të cilit të provohen arsyet e skualifikimit të shtetasit J. S nga konkurimi për në Kolegjin e Policisë.
- Informacion lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore (si dhe kopje të tyre), në të cilat është e parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë për kandidatët për punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit.
- Kopje të Vendimit nr. 1, datë 25.01.2024, “Për pranimin në Polici të aplikantëve të shpallur fitues në procesin e konkurimit”, të Komisionit të Vlerësimit.

- Kopje të përgjigjes së DPPSH ose korrespondencës së mbajtur, lidhur me ankesën e bërë nga subjekti ankues kundër vendimit të skualifikimit nga procesi i konkurimit (neni 141, pika 1 e Rregullores së Policisë së Shtetit), si dhe të Vendimit nr. 1/1 datë 02.02.2024, marë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave.
  - Kopje të Urdhrit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, lidhur me rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave (neni 141, pika 2 e Rregullores së Policisë së Shtetit).
  - Si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Në përgjigje të sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me datë 18.04.2024, ka dërguar pranë Komisionerit, informacionin e dokumentacionin e kërkuar, klasifikuar si “sekret”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

## **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në nenet 37 dhe 38, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrit nr. 1461, datë 11.10.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”, z. J. S ka konkuruar për fitimin e gradës “Nënkomisar” dhe emërimin në strukturat e Drejtorisë Vendore Dibër.

Procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë parashikohen specifikisht në Rregulloren për Policinë e Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015.

Në nenin 135, të Rregullores për Policinë e Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, përcaktohen të gjitha fazat e konkurimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Neni i sipërcituar parashikon: *“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:*

- a) testimin me shkrim;*
- b) testimin të aftësive fizike;*
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimin të aftësive të shkruarit;*
- ç) testimin psikologjik;*
- d) kontrollin shëndetësor;*
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;*
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit”.*

Në nenin 139, të Rregullores për Policinë e Shtetit miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, parashikohet se:

*“1. Aplikanti që kalon me sukses procesin e testimin të përcaktuar në nenin 135, germa “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet procesit të verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.*

*2. Numri i aplikantëve që do t’i nënshtrohen procesit të verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është i njëjtë me kuotën për konkurim të përcaktuar në fillim të procesit.*

*3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.*

*4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.*

*5. Relacioni(lidhja 17) me dokumentacionin e çdo aplikanti fitues, i dërgohet Akademisë së Sigurisë”.*

Neni 140, i kësaj Rregulloreje, përcakton rastet e skualifikimit të aplikantit, në rastet e mëposhtme, kur ai:

- “a) nuk kalon testimin me shkrim;*
  - b) nuk kalon testimin e aftësive fizike;*
  - c) nuk kalon testin psikologjik;*
  - ç) nuk paraqitet në kohën e caktuar në një nga fazat e testimit;*
  - d) ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të falsifikuara;*
  - dh) pas procesit të verifikimit përfundimtar, rezulton se ai ose pjesëtarë të familjes së tij janë të dënuar për vepra të rënda penale;*
  - e) rezulton përdorues droge;*
  - ë) rezulton të ketë varësi nga alkooli.*
- 2. Aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurrimit, sipas rendit të përcaktuar në nenin 135 të kësaj rregulloreje, humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurrimit dhe skualifikohet.”*

Neni 141, i Rregullores, parashikon procesin e ankimit të aplikantit, për pranimin në Akademinë e Sigurisë, duke përcaktuar se:

*“1. Aplikanti ka të drejtën e ankimit në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, pas çdo faze të konkurimit apo në institucionet e mbikëqyrjes së jashtme të policisë.*

*2. Rregullat, procedurat e shqyrtimit të ankesës, si dhe përbërja e Komisionit përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.”*

**- Nga këqyrja e akteve të depozituara dhe në analizë të sa më sipër, rezulton se:**

Z. J. S ka kaluar me sukses të gjitha fazat e konkurimit për në Akademinë e Policisë, duke mbërritur në fazën e Verifikimit Përfundimtar.

Mbështetur në parashikimin e nenit 139, të Rregullores sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka kryer procedurat e verifikimit, nga ku ka rezultuar se, shtetasi J. S nuk është i përshtatshëm për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Vlerësimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Vendimin nr. 1, datë 25.01.2024, ka vendosur skualifikimin e shtetasit J. S nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë, për shkak se nuk plotëson kriterin e besueshmërisë për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.

Me e-mailin e datës 26.01.2024, të strukturave përgjegjëse të DPPSH-së<sup>2</sup>, z. J. S është njoftuar për skualifikimin e tij nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Policisë.

---

<sup>2</sup> Citjmë përmbajtjen e e-mailit: “...ju njoftojmë se Komisioni i Vlerësimit, në DPPSH, pas shqyrtimit të verifikimit përfundimtar të besueshmërisë, i cili përfshin midis të tjerash, verifikimet e strukturave hetimore qendrore, bazuar në nenin 140, të Rregullores së Policisë së Shtetit, ka vendosur skualifikimin tuaj nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë... Keni të drejtën e ankimit, brenda dy ditëve nga marrja e njoftimit, duke nisur nga data e sotme, në adresën elektronike: [burimet.njerezore@asp.gov.al](mailto:burimet.njerezore@asp.gov.al)”

Subjekti ankues, në respektim të afatit të përcaktuar, ka ushtruar të drejtën e ankimimit të vendimit të njoftuar për skualifikimin e tij nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Policisë.

Pas shqyrtimit të ankimimit të z. S, DPPSH, nëpërmjet e-mailit të datës 02.02.2024, i ka komunikuar ankuesit, si më poshtë vijon:

*“...Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, mori në shqyrtim ankesën tuaj, nëpërmjet të cilës kërkonte rishikimin e Vendimit nr. 1, datë 25.01.2024, të Komisionit të Vlerësimit, me anët të të cilit jeni skualifikuar, për mosplotësim të kriterit të besueshmërisë.*

*Me Vendimin nr. 1/1, datë 02.02.2024, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vendosi të lërë në fuqi Vendimin nr. 1, datë 25.01.2024, të Komisionit të Vlerësimit.*

*Sa më sipër, ju skualifikoheni nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë, për shkak se nuk plotësoni kriterin e besueshmërisë për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.”*

Për rrjedhojë, bazuar sa sipërcituar, Komisioneri vëren se ankuesi ka ezauruar të drejtën e ankimimit dhe nga ana e strukturave të posaçme të DPPSH-së, atij i është shqyrtuar ankesa si dhe i është kthyer përgjigje në respektim të afateve kohore të përcaktuara në aktet rregullatore.

Sa më sipër, në ankesën me nr. 61 regj., datë 27.03.2024, ankuesi ka pretenduar pranë KMD-së se diskriminohet nga DPPSH, lidhur me skualifikimin e tij nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Policisë, për shkak të gjendjes familjare.

Gjithashtu, referuar kërkesë-padisë së depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, rezulton se pretendimet e tij kundër DPPSH-së, lidhur me skualifikimin e tij nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë, ai i ka ngritur gjyqësisht. Në objekt të kërkesë-padisë, ankuesi kërkon nga Gjykata, shprehimisht, si vijon:

*“1. Marrjen e masës provizore (sigurim padie):*

*Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1 datë 25.01.2024, për skualifikimin nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1/1 datë 02.02.2024, i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave që ka lënë në fuqi Vendimin nr. 1 datë 25.01.2024, për skualifikimin nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Vijimin e pranimin në Akademinë e Sigurisë.*

*2.-Shfuqizimi i aktit administrative: Vendim nr. 1 datë 25.01.2024 “Për skualifikimin nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë.*

*3.-Shfuqizimi i aktit administrative: Vendim nr. 1/1 datë 02.02.2024 “Për lënien në fuqi të Vendimi Nr. 1, datë 25.01.2024 “Për skualifikimin nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë.*

*4.-Pagimin e shpenzimeve gjyqësore dhe ato për një avokat të kryera nga paditësi.*



Gjatë hetimit administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me datë 18.04.2024, me shkresën e klasifikuar “sekret”, ka dërguar pranë KMD-së, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Nisur nga sa më sipër, lidhur me klasifikimin “sekret” të shkresës sipërcituar, Komisioneri, referon tek aktet ligjore në fuqi të cilat kanë si objekt, fushë veprimi dhe qëllim, vendosjen e rregullave të detyrueshme për ruajtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë dhe i rregullave për krijimin, administrimin, deklasifikimin, zhvlerësimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të tij.

Neni 2, i ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, përcakton se: *“Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, komprometimi ose ekspozimi i paautorizuar.”*

Neni 3, i këtij Ligji, përcakton se: *“Ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë për të cilët për ushtrimin e detyrave të tyre dhe bazuar në parimin “nevojë për njohje” kërkohet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar...”*

Në kuptim të këtij Ligji<sup>3</sup>, dokument i klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ është çdo dokument i regjistruar, pavarësisht formës fizike ose karakteristikave, përfshirë dokumentin e shkruar të printuar ose në formë elektronike, klasifikuar sipas këtij ligji.

Neni 6, i këtij Ligji, përcakton se:

*“1. Institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, që kanë qasje në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, zbatojnë të gjitha masat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në përputhje me kërkesat e këtij ligji.*

*2. E drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar kufizohet vetëm tek ata persona që kanë nevojë për njohje dhe përmbushin kriteret e sigurisë.*

*3. Një institucion nuk ka të drejtë të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga një institucion tjetër pa autorizimin e këtij të fundit.*

*4. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar është i klasifikuar, referuar pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.*

*5. Informacioni nuk publikohet kur është i klasifikuar “sekret shtetëror”.*

*6. Çdo individ ka për detyrë që të mbrojë informacionin e klasifikuar sipas këtij ligji, pavarësisht nga mënyra se si ai ka arritur ta posedojë apo ta garantojë të drejtën e njohjes së këtij informacioni të klasifikuar...”*

Referuar nenit 28, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, ku përcaktohen kriteret për njohjen me informacionin e klasifikuar, përcaktohet:

<sup>3</sup> Neni 4, pika 6, e ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.



*“1. Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm personat, që: a) sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit...”*

Bazuar në dispozitat sipërcituar, për shkak të natyrës dhe informacionit të klasifikuar “sekret”, informacioni i dërguar nga DPPSH, është konsultuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ndodhur në këto rrethana faktike e ligjore, informacioni dhe dokumentacioni i dërguar nga DPPSH, pasi është konsultuar nga Komisioneri, është vlerësuar prej tij, si informacion që i ka dhënë përgjigje arsyes së skualifikimit të shtetasit J. S nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se nuk ka tagër të vlerësojë shkakun/arsyen e dhënë nga DPPSH-ja për këtë rast, por merr të mirëqenë informacionin e dhënë nga institucioni lidhur me besueshmërinë e aplikantit për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit<sup>4</sup>.

Komisioneri për shkak të informacionit që është i klasifikuar sekret, nuk mund të japë të dhëna e detaje të tij, por mbi bazën e sa konsultoi nga përgjigja e dokumentacioni në fjalë, krijoi bindjen për vlerësim objektiv të ankuesit nga ana e DPPSH-së, lidhur me skualifikimin e tij nga procesi i konkurimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë.

Në përfundim të shqyrtimit të informacionit, Komisioneri vlerëson se, vendimi i marrë nga DPPSH-së kundrej ankuesit, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1, e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 17/2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet t’i refuzohet një personi ose grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

<sup>4</sup> Për analogji me rastin e ankuesit, citojmë Vendimin nr. 37, datë 06.02.2024, të KMD-së (<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2024/02/Vendim-nr.-37-date-06.02.2024-K.V-kunder-DPPSH-Mosdiskriminim.pdf>)

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. J. S për shkakun e pretenduar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**